

VENDIM
Nr. 165, datë 12.3.2025

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 848, DATË 28.10.2020,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR STANDARDET, KRITERET E
PROCEDURAT E AKREDITIMIT TË AKTIVITETEVE TË EDUKIMIT TË
VAZHDUESHËM TË PROFESIONISTËVE TË SHËRBIMEVE TË KUJDESIT
SHOQËROR, SI DHE TË OFRUESVE TË TYRE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 39, pika 2, e 43, pika 4, të ligjit nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 848, datë 28.10.2020 të Këshillit të Ministrave, “Për standardet, kriteret e procedurat e akreditimit të aktivitetëve të edukimit të vazhdueshëm të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, si dhe të ofruesve të tyre”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në të gjithë përmbajtjen e vendimit, emërtesa “Qendra Kombëtare e Edukimit të Vazhdueshëm” zëvendësohet me “Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor e Shoqëror (në vijim, ASCK)”.

2. Në pikën 2, të kreut II, pas fjalës “... licencuara ...” shtohen fjalët “... për ushtrim të veprimtarisë në fushën e kujdesit shoqëror ...”.

3. Fjalja e parë, e pikës 3, të kreut III.2, “Procesi i akreditimit”, ndryshohet, si më poshtë vijon:
“Aplikimi për akreditimin e aktivitetit të edukimit të vazhdueshëm për profesionistët e shërbimeve të kujdesit shoqëror bëhet në shërbimin *on-line*, që ka Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror nëpërmjet portalit “*e-Albania*”.”.

4. Pika 16, e kreut III.2, “Procesi i akreditimit”, ndryshohet, si më poshtë vijon:
“16. ASCK-ja shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga aplikuesi nëpërmjet shërbimit *on-line*, që ofrohet përmes portalit “*e-Albania*”, me dokument me vullë elektronike dhe, nëse ai është i plotë, bën vlerësimin e tij sipas kriterëve të cilësisë në planifikimin e aktivitetit, përfshirë vlerësimin e burimeve të përdorura (trajnerët, materialet pedagogjike) dhe përgatit raportin përkatës. Në rast se kërkesa nuk është e plotë, ASCK-ja cakton një afat për plotësimin e saj dhe, pas paraqitjes së plotë të dokumenteve, e merr atë në shqyrtim. Kur kërkesa nuk plotësohet brenda afatit të përcaktuar, kërkesa kthehet dhe konsiderohet se nuk është paraqitur.”.

5. Pas pikës 4, të kreut VII, shtohet pika 4/1, me këtë përmbajtje:
“4/1. Kërkesat, për të cilat nuk kanë përfunduar procedurat administrative deri në hyrjen në fuqi të këtij vendimi, trajtohen në përputhje me dispozitat në fuqi, në kohën e paraqitjes së tyre.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku